

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KOMUNA GLLOGOC**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **611-19-8209-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me Material Shpenzues për Analiza Hematologjike dhe Biokimike, Ri-tenderim**

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

BIOTEK KOSOVO" SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr.Vicianum nr300 – Arberia Nr. 3

(Adresa)

Prishtinë

10000

(Vendi)(Kodi postar)

+ 381 38 732 259

+ 381 38 732 259

(Numri Telefonit)(Numri i Faks-it)

Dejan Sinadinov, Drejtor

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

biotek-kosovo@biotek.com.mk

(Adresa elektronike)

18.11.2019

(Data e parashtrimit të kërkesës)(Nënshkrimi dhe vula)

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi per Kontrate me 28/10/2019

Data për pyetje Sqaruese 18/11/2019

Afati i fundit per pranim te tenderve: 19/11/2019

Data e Hapjes së Tenderit: 19/11/2019

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☐

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

☐

Jo

☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-se

Neni 6 i LPP-se

Neni 7 i LPP-se

Neni 51 i LPP-se

Neni 4.1 i Rregulave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit

Neni 4.4 i Rregulave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit

Neni 18.9 i Rregulave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit

Neni 19 i Rregulave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit

Neni 26 i Rregulave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

- Me datën 28/10/2019 është përgatitur njoftimi për Kontratë me numër të prokurimit **611-19-8209-1-1-1** nga Autoriteti Kontraktues KOMUNA E GLLOGOVICIT me titull FURNIZIM ME MATERIAL SHPENZUES PER ANALIZA HEMATOLOGJIKE DHE BIOKIMIKE- RITENDERIM.
- Në cilësi të Operatorit Ekonomik ("OE") të Intersuar për pjesëmarrje në këtë tender dhe që të ofertojmë, me rastin e analizimit të të njëjtit kemi vërejtur që i njëjti është shumë i pa-favorshëm pasi që përmes mënyrës së paraqitjes së këtij tenderi rezulton që i njëjti nuk është i ndarë në lloje përkundër faktit që një tender i tillë do të ishte shumë më efikas për Autoritetin Kontraktues

("AK") si në aspektin financiar ashtu edhe në realizimin e porositve nga OE fitues. Duke mos e ndarë në lloje, rezulton që kriteret për përzgjedhje janë diskriminuese dhe me pretendim për favorizim të një OE të vetëm.

- Nga vetë titulli i kontratës si në njoftim rezulton që në cilësi të AK-së keni përfshirë të gjitha materialet shpenzuese në një kontratë e që duke se i përshtatet një operatori të caktuar ekonomik.

Duke pasur këtë parasysh, rezulton që ky tender që të ishte në përputhje me dispozitat e aplikueshme ligjore (primare dhe sekondare) do të duhej që të ndahej në llojet si në vijim:

- Material Shpenzues për Biokimi;
 - Material Shpenzues për Hematologji (në bazë të pajisjes)
 - Material Shpenzues për Hemostazë (koagulim)
 - Material Shpenzues për Imunologji
 - Pjesë Rezervë (në bazë të pajisjes)
 - Material shpenzues;
- Furnizimi i të gjitha kërkesave si më lartë është pothuajse i pamundshëm dhe i pa përshtatshëm që Ak të furnizohet për të njëjtat pajisje me materialin e njëjtë shpenzues. Përmes kësaj e ri-theksojmë që kjo formë e kërkesës duket e përgatitur qartazi për ndonjë Operator të caktuar Ekonomik.
 - NË KËTË MËNYRË, nga AK-ja është më se e qartë që është shkelur Neni 1 i LPP-së pasi që nuk është marrë parasysh qëllimi i këtij Ligji sepse në një mënyrë si është paraqitur nuk është siguruar fare efikasiteti dhe transparenca por gjithashtu rezulton që edhe shfrytëzimi i fondeve publike të caktuara për këtë tender nuk do të bëhet në mënyrë ekonomike. Me këtë shkelet edhe parimi i ekonomicitetit sipas LPP-së (Neni 6 i LPP-së).
 - PËRMES, Njoftimit të kësaj Kontrate shkelet edhe Neni 7-të i LPP-së lidhur me Nenin 4.4 të RRUOP-së pasi që ky aktivitet i prokurimit rezulton që nuk është duke u udhëhequr mbi bazën e parimeve bazike të prokurimit publik, pasi që transparenca, efikasiteti, mos-diskriminimi dhe profesionalizmi duket që nuk është për qëllim i AK-së që të merren parasysh. Me këtë është shkelur edhe Neni 4.1 i RRUOP-së pikërisht për shkak të trajtimit të pa-barabartë dhe diskriminimit ndërmjet Operatorëve Ekonomik që shprehin interesimin për ofertim por për shkak të mos-ndarjes në lloje (edhe pse AK është në dijeni që është e vështirë të kryhet nga një OE i vetëm).
 - Me veprimet e AK-së sipas Njoftimit për Kontratë është shkelur edhe Neni 18.9 i RRUOP-së sepse pikërisht në kundërshtim me këtë dispozitë dosja e tenderit duket që është përgatitur për një operator të caktuar (duke u eliminuar konkurrenca) dhe duke i/e diskriminuar OE të tjerë të cilët nëse do të ndahej Konteata / Dosja në LLOTET E Propozuara si më lartë do të kishin mundësi që të ofertonin, gjithmonë me çmime më të favorshme dhe me sukses shumë më të lartë nëse të gjitha kërkesat si në dosje ofrohen vetëm nga një Operator i caktuar Ekonomik.
 - AK -es me rastin e njoftimit për Kontratë sipas Dosjes së Tenderit nuk e ka aplikuar fare Nenin 19.2 të RRUOP ashtu që në Dosjen e Tenderit të lejonte

OE të interesuar të ofertojnë ose për të gjitha llotet dhe të shpërblehen me maksimumin e lejuar të lloteve (varësisht nga suksesi në ofertë) ose që OE të ofertoj për një Llot të caktuar dhe pastaj vetë AK të vlerësoj nëse është më e arsyeshme që një OE t'i lejohet numri i caktuar i lloteve apo edhe të ndahet varësisht nga cmimi më i ulte i secilit ofertues.

- NË mënyrën se si është hartuar dosja e tenderit, rezultojnë të shkelura Neni 56 i LPP-së lidhur me Nenin 26 të RRUOP sepse kriteret e përzgjedhjes respektivisht kërkesat minimale të caktuara nga AK për dhënien eventuale të Kontratës.

PRANDAJ, duke i pasur parasysh pretendimet ankimore të prezentuar si më lartë, Autoritetit Kontraktues i propozojmë në kuptim të Nenit 6.1 të RRUOP me:

VENDIM

TË PEZULLOJ Aktivitetin e Prokurimit **611-19-8209-1-1-1** lidhur me Tenderin **Furnizim me Material Shpenzues për Analiza Hematologjike dhe Biokimike, Ri-tenderim** ashtu që

TË APROVOHET SI E BAZUAR KJO KËRKESË dhe ky Aktivitet Prokurimi të të NDAHET ne Llotet e propozuara si më lartë.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Si rezultat i pamundësisë për pjesëmarrje në këtë tender për shkak të shkeljeve të elaboruara si më lartë, OE Ankues e konsideron pësim dëmit fitimin që do të fitonte për llotet që është i bindur se mund të dorëzoj ofertëm më të suksesshmë.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mospara-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*